



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. H-43 Prot.
12

Tiranë, më 08/07/2021

URDHËR

Nr. 397 datë 08/07/2021

**“PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT,
NOTERIT HYSNI AHMETAJ”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “ë”, të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”,

KONSTATOJ:

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 346, datë 17.05.2021, “Për fillimin e hetimit administrativ për mos ushtrimin e veprimtarisë së Noterit Hysni Ahmetaj”, është ushtruar kontrolli në zyrën noteriale të noterit Hysni Ahmetaj, i cili e ushtron veprimtarinë e tij në Bashkinë Tiranë.

Ky kontroll është ushtruar pasi nga ana e noterit Hysni Ahmetaj është përcjellë shkresa me nr. I-68/2 prot., datë 28.01.2021, në vijim të kërkesës për informacion të nisur nga Ministria e Drejtësisë në lidhje me ankesën e shtetasit I.L. Në këtë shkresë noteri na ka informuar se për shkaqe familjare në muajin shtator 2019 ka shkuar në SHBA për të proceduar me vaksinimin e fëmijës sipas kalendarit përkatës. Po ashtu, me anë të kësaj shkrese z. Ahmetaj është shprehur se nuk ka bërë kërkesë për pezullimin e veprimtarisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, për arsye se afati i qëndrimit në SHBA ka qenë i papërcaktuar në terma kohorë duke qenë i varur nga ecuria shëndetësore, si dhe sipas tij do të ishte fizikisht në zyrë brenda një periudhe jo më shumë se 3 muaj nga nënshkrimi i shkresës së dërguar. Ndërkohë, nga ana e tij nuk është përcjellë asnjë vërtetim shëndetësor në lidhje me parashtrimet e mësipërme.

Nga verifikimet e kryera nga grupi kontrollit caktuar me Urdhrin nr. 346, datë 17.05.2021 rezultoi se zyra noteriale e deklaruar nga noteri Hysni Ahmetaj, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, nuk u gjend, në këtë adresë ku është ushtruar më parë veprimtaria noteriale, nga noteri Hysni Ahmetaj, tashmë ushtronte veprimtarinë e saj tregtare, një agjenci udhëtimi me emrin “AS Travel”.

Gjithashtu, sipas të dhënave në ekstraktin historik të QKB, rezulton se noteri ka pezulluar aktivitetin e tij duke filluar nga data 04.03.2020, si dhe nga verifikimi i realizuar në Regjistrin Noterial Shqiptar rezulton që ky noter të mos ketë regjistruar akte/veprime noteriale që prej datës 07.09.2019.

Në nenin 18, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, përcaktohen ndër të tjera, rastet kur noteri mund të kërkojë pezullimin, afatet e pezullimit, si dhe autoritetin që ka kompetencën për pranimin e kërkesës për pezullim. Referuar kësaj dispozite parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për pezullim, Ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, dhe është Ministri i Drejtësisë ai që vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës.

Nga verifikimi i kryer rezulton që noteri Hysni Ahmetaj nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë noteriale, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar edhe veprimin të fundit të realizuar nga noteri Hysni Ahmetaj në RNSH, datë 07.09.2019, konstatohet se noteri ka mbi një vit që nuk ofron shërbim ndaj publikut, pa miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

Gjithashtu, me shkresën nr. L-61/1, datë 07.06.2021, si dhe në rrugë elektronike (e-mail) është përcjellë raporti “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik Hysni Ahmetaj”, noteri Hysni Ahmetaj, dhe në përputhje me parimet dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi, noteri i është dhënë mundësia të njihet dhe të sjellë argumentat e tij mbi gjetjet e këtij raporti. Nga ana e z. Ahmetaj nuk është përcjellë asnjë mendim/argument lidhur me këtë raport.

Ndërkohë, pranë Ministrisë së Drejtësisë, më datë 22.06.2021, është protokolluar me nr. H-43 prot., shkresa e dërguar nga z. Hysni Ahmetaj, përmes së cilës deklaron heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit në bazë të pikës 1, gërma “a”, të nenit 21, të Ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”. Nga verifikimi kryer rezulton që kjo shkresë të jetë nisur nga z. Ahmetaj më datë 27.05.2021, pra pasi ai është njoftuar mbi Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 346, datë 17.05.2021 me të cilin është vendosur fillimi hetimit administrativ për mos ushtrimin e veprimtarisë nga ana e tij.

Në Ligjin nr. 110/2018 “Për noterinë” është parashikuar e drejta që ka noteri për të hequr dorë nga ushtrimi i këtij profesioni, pasi i paraqet kërkesë Ministrit të Drejtësisë, dhe sipas ligjit është Ministri i Drejtësisë ai i cili del me urdhër për heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit.

Referuar fakteve të sipërpërmendura rezulton se, kërkesa e paraqitur nga z. Hysni Ahmetaj për heqjen dorë vullnetarisht nga ushtrimi i profesionit të noterit është bërë pasi ai ka marrë dijeni për Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 346, datë 17.05.2021 me të cilin është vendosur fillimi hetimit administrativ për mos ushtrimin e veprimtarisë nga ana e tij. Vërtetuar kjo pasi me shkresën nr. L-18/3 prot., datë 20.05.2021 i është përcjellë për njohje Urdhri Ministrit të Drejtësisë nr. 346, datë 17.05.2021 z. Hysni Ahmetaj në adresën “Rruga Demokracia, nr. 254, Qendër, Babrru, Paskuqan, Tiranë”, dhe nga lajmërimarrja përcjellë në Ministrinë e Drejtësisë nga shërbimi postar rezulton se, zarfi me këtë shkresë është dorëzuar nga shërbimi postar më datë 22.05.2021.

Si përfundim, referuar rrjedhës kronologjike të fakteve të sipërcituara, si dhe parashikimeve ligjore të nenit 63, ku përcaktohen “Detyrat e Noterit”, dispozitë e aplikuar për rastin në fjalë, në harmoni

- me parashikimet e nenit 18 mbi kërkesën për “Pezullimin e përkohshëm i licencës së noterit me kërkesën e tij”, ashtu dhe parashikimeve të pikës 1, gërma “a” të nenit 21, për rastet e Heqjes së Licencës me kërkesën e tij, konkludojmë se pavarësisht të gjitha instrumentave ligjore që ka patur ky subjekt, me neglizhencë apo vetëveprim ka sjellë si pasojë, braktisjen e detyrës.

Rezulton se, noteri Hysni Ahmetaj është në kushtet e braktisjes së detyrës sipas parashikimeve të nenit 63, pika 1, gërma “m” ku citohet se: *“Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme...siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim”.*

Gjithashtu në pikën 1, gërma “ë”, të nenit 21, të Ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, parashikohet se: *“1. Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri... ë) nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë,*

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “ë”, të pikës 1, të nenit 21, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”,

URDHËROJ:

- Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Hysni Ahmetaj, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Tiranë, pasi nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohore mbi një vit, pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.
- Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - Znj. Ina Papa, Sektori i Rregullimit të Profesioneve të Lira pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë;
 - Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
- Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Hysni Ahmetaj, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij Urdhri.
- Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.

5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Dega Vendore e Noterisë Tiranë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijani e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”.
7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë, brenda 10 ditëve pune.
8. Ndaj këtij urdhri, noterit mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Tiranë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
11. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij Urdhri noterit Hysni Ahmetaj, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Etilda Gjona (Saliu)
